



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit:22.24.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRISË**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Mehmet Muçaj (udhëheqës ekipi) dhe Shpresa Zenelaj e Mehmet Kurti (antarë).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	30
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	31
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	34


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë (më tutje: komuna) për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 26.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti):

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinionin e Pamodifikuar me theksim të çështjes” sepse pasuritë e komunës ishin mbivlerësuar për 8,193,199€.


Në emër të një projekti në vitin 2015, ishin paguar dhe raportuar shpenzime kapitale në PVF 30,000€, ndërsa nuk është përfituar ndonjë kundërvlerë për mjetet e dhëna.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi të nën kapitulli 1.2 i këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në aspektin e raportimeve në nivelin e tanishëm ofron sigurinë se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen, por ende ka nevojë të ketë një mbikëqyrje të shtuar në përmirësim të disa fushave.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Kontrollet e brendshme ishin jo mjaft efektive në disa sisteme të rëndësishme si: të hyrat vetjake dhe menaxhimi i pasurive



Kryetari duhet t'i forcoj kontrollet në këto fusha dhe të siguroj një menaxhim efektiv me të hyrat dhe pasuritë e komunës (shih çështjet 13, 14, 15 dhe 16)

### **Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin e vitit 2015**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF e vitit 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### PËR KOMUNËN E VUSHTRRISË

#### OPINION I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar me 31.12.2015, të cilat përfshijnë 'Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale', Shënimet shpjeguese dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

#### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

### **Theksim i Çështjes**

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se pasuritë e komunës për vitin 2015 ishin mbivlerësuar për 8,193,199€. Kjo ka ndodhur për faktin se në vend që të regjistrohej pagesa në vlerë 82,358€ për ndërtim të Shkollës fillore në fshatin Maxhunaj, ishte regjistruar gabimisht si 8,153,598€. Po ashtu, pagesa 39,601€ për asfaltimin e rrugës Karaq - Gumnishtë ishte regjistruar dy herë në regjistrin e pasurisë. Vlen të theksohet fakti se komuna ka ndër marr hapat e menjëhershëm dhe kjo vlerë në regjistrat e pasurive për vitin 2016 është korrigjuar.

Në emër të një projekti në vitin 2015, ishin paguar dhe raportuar shpenzime kapitale në PVF 30,000€, ndërsa nuk është përfituar ndonjë kundërvlerë për mjetet e dhëna. Opinioni i Auditimit nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

### **Çështje tjetër**

Ne nuk kemi audituar shpenzimet në vlerën 257,111€ të bëra nga grandit BE-së për projektin "Themelimi i zingjirit të qëndrueshëm ekonomik për riciklim të materialeve të ngurta" edhe pse ato mjete janë hyrë dhe shpenzuar përmes llogarisë së thesarit (SIMFK). Arsyeja pse ne nuk kemi audituar këtë vlerë është se sipas marrëveshjes, autoritet kontraktues është BE ndërsa komuna në rolin e koordinatorit si dhe verifikimi i këtyre fondeve sipas marrëveshjes parashihet të bëhet nga auditori i jashtë i caktuar nga BE.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.



Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre Pasqyrave Vjetore Financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.

## 1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

### **Përshkrimi**

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 26.10.2015, janë identifikuar dy rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Rreziqet e planifikuara kanë të bëjnë me mos prezantimin e drejtë të pagesave nga palët e treta dhe keq klasifikimin e shpenzimeve në PVF.

Rreziku i keq klasifikimit – Ky rrezik nuk është materializuar pasi që komuna kishte arritur të regjistroj shpenzimet në kode adekuate.

Rreziku i dytë domethënës, që ka të bëjë me prezantimin e pagesave të palëve të treta në PVF, gjithashtu, nuk është materializuar pasi që komuna kishte prezantuar në PVF këto pagesa në mënyrë të saktë.

## 1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal; dhe
- Planin e prokurimit

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Draft PVF-të përmbajnë gabime lidhur me prezantimin e vlerës së pasurisë.

---

### Çështja 1 - Gabimet në PVF- Prioritet i lartë

**E gjetura** Në emër të një projekti në vitin 2015, ishin paguar dhe raportuar shpenzime kapitale në PVF 30,000€, ndërsa nuk është përfituar ndonjë kundërvlerë për mjetet e dhëna, për shkak se punimet priten të fillojnë në vitin 2016 (për më tepër shih çështjen 10); dhe

Në nenin 16 shpalosja e pasurive - Pasuritë totale të prezantuara në PVF ishin në vlerë 110,877,950€. Kjo vlerë nuk është e saktë për faktin se në vend që të regjistrohej pagesa në vlerë 82,358€ për ndërtim të Shkollës fillore në fshatin Maxhunaj, ishte regjistruar 8,153,598€. Po ashtu, pagesa 39,601€ për asfaltimin e rrugës Karaq - Gumnishtë ishte regjistruar dy herë në regjistrin e pasurisë. Si rezultat i kësaj, pasuritë komunale ishin mbivlerësuar për 8,193,199€. Kjo vlerë e mbivlerësuar ishte e shpalosur në PVF për vitin 2015. Vlen të theksohet fakti se komuna ka ndërmarr hapat e menjëhershëm dhe kjo vlerë në regjistrat e pasurive është korrigjuar.

## 1.5 Rekomandimet

**Rekomandimi 1 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime.

---

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që është plotësuar nga komuna siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Rishikimet tona kanë identifikuar disa mangësi në fushën e qeverisjes së mirë, të cilat janë paraqitur më poshtë.

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që bazohen pjesërisht në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes janë përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe adresimi i plotë i rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

### 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014, ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet. Ne vlerësojmë se menaxhmenti ende ka nevojë të forcoj procesin e llogaridhënies së menaxherëve në zbatimin e rekomandimeve.

Raporti i auditimit për PVF e vitit 2014 ishte diskutuar në Kuvendin Komunal me datën 30 korrik 2015, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të komunës.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, tri (3) rekomandime ishin implementuar, katër (4) ishin adresuar dhe janë në proces të implementimit dhe tri (3) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

## Çështja 2 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Përkundër disa veprimeve të ndërmarra vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar. Komuna ka ndjekur një proces formal të adresimit, por nuk kishte arritur të menaxhoj dhe monitoroj në tërësi implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

**Rreziku** Dobësitë e përsëritura të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare dhe fushat tjera të veprimtarisë kanë rezultuar me:

(a) Procedurat e prokurimit jo në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e LPP-së dhe shmangie në disa raste nga kërkesat standarde në procesin e prokurimit; dhe

(b) Mos trajtim të llogarive të arkëtueshme nga aspekti i ri vlerësimit të llogarive të tilla.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar dhe një monitorim rigoroz i këtij procesi. Sugjerojmë që edhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal të jetë pjesë e këtij procesi.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Në kuadër të auditimit të ndërmarr, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF. Më poshtë, ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Ne kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentë dhe konsiderojmë që komuna kishte adresuar përgjigjet në nivel të kënaqshëm. Ato ishin mirë të dokumentuara me dokumentacion mbështetës dhe sqarime të mjaftueshme.

### Rekomandim

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Komuna pritet të zbatoj vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

#### Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

- E gjetura** Pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka ri konfirmuar se në disa raste merren në konsideratë rreziqet, por komuna ende nuk ka identifikuar rreziqet në formë të shkruar të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj hartimin e listës së rreziqeve si dhe alternativën për të evituar rreziqet e mundshme në raste të ndodhjes. Një proces rishikimi duhet të aplikohet nga auditimi i brendshëm për të konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

### 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Mirëpo është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar. Raportimet mbahen në baza javore ku drejtorët e drejtorive raportojnë tek Kryetari i Komunës dhe për çdo takim mbahen procesverbale të shkruara.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim për këtë fushë.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një anëtarë dhe drejtori i NJAB. NJAB kishte përgatitur planin e auditimit dhe ky plan ishte i aprovuar nga menaxhmenti i komunës. Plani vjetor i Auditimit të Brendshëm, fushën e prokurimit e ndanë në dy raporte. Kjo njësi kishte planifikuar 5 raporte të auditimit dhe një sipas kërkesës, ndërsa kishte kryer pesë sish. Raportet e kryera nga NJAB ishin: (a) raport për zyrën e prokurimit për vitin 2014 (vlerësimi sistemit të kontrollit të brendshëm); (b) raport për drejtorinë për buxhet dhe financa për vitin 2015 (realizimi i të hyrave vetjake); (c) raport për drejtorinë e urbanizmit për vitin 2015 (vlerësimi sistemit të kontrollit të brendshëm); (d) raport për fushën e prokurimit për vitin 2015; dhe (e) raporti për drejtorinë e kulturës rinisë dhe sportit për vitin 2015.

Komiteti i Auditimit (KA) kishte mbajtur takimet e rregullta vjetore dhe për këto takime kishte përgatitur procesverbale të shkruara.

---

### Çështja 4 - Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit- Prioritet i lartë

**E gjetura** NJAB, edhe pse në planin vjetor kishte vlerësuar fushën e pasurive si fushë me rrezik të lartë, kjo njësi nuk kishte arritur të bëjë auditim për këtë fushë në vitin 2015, por në vend të saj kishte audituar shpenzimet dhe të hyrat në drejtorinë e kulturës.

Ne kemi rishikuar punën e auditimit të brendshëm për Drejtorinë e Urbanizmit dhe kemi vërejtur se NJAB si objektiv e kishte vetëm taksën administrative. Ne identifikua se për leje ndërtimore komuna kishte ngarkuar me taksë dhe tarifë qytetarët sipas çmimores në rregullore, por hapësira e bodrumit, ishte trajtuar jo në mënyrë uniforme.

**Rreziku** Raporti i auditimit me fokus vitin paraprak, nuk i shton vlerë përmirësimit aktual të aktiviteteve operative dhe zbatimit të kontrolleve. Mos përmbushja e planit vjetor të AB, rritë rrezikun që objektivat e planifikuara lidhur me përshtatshmërinë e kontrollit të brendshëm të mos arrihen.

Mangësitë e cekura më lartë, ndikojnë që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet dhe kjo i pamundëson menaxhmentit të ndërmerr veprimet e duhur në drejtim të përmirësimit të sistemeve.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të siguroj se plani vjetor i NJAB të përmbushet, dhe fushat të cilat konsiderohen me rrezik të lartë, të jenë prioritet i njësisë së auditimit dhe të siguroj që trajtimi i çështjeve nga AB të jetë më gjithëpërfshirës.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi çertifikimin e pagesave në përgjithësi janë të vendosura por nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale, procesi i prokurimit, menaxhimi i kontratave, pagesat bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe menaxhimi i pasurive.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>14,625,419</b>	<b>15,801,289</b>	<b>14,915,393</b>	<b>14,103,855</b>	<b>12,243,211</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	12,950,092	13,149,838	13,118,126	12,756,447	10,948,734
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	0	493,421	384,808	404,515	411,489
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,675,327	1,675,327	1,050,239	889,043	824,543
Donacionet e brendshme	0	109,815	76,536	44,877	40,453
Donacionet e jashtme	0	372,888	285,684	8,973	17,992

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,175,870€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve (482,703€), të hyrave të bartura (493,421€) si dhe rritjes së grantit të Qeverisë (199,746€) pas rishikimit buxhetor.

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunës, të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Në vitin 2015 komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final, që krahasuar me vitin kaluar (91%). Në përgjithësi, kjo mund të konsiderohet një performancë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>14,625,419</b>	<b>15,801,289</b>	<b>14,915,393</b>	<b>14,103,855</b>	<b>12,243,211</b>
Pagat dhe Mëditjet	9,110,000	9,402,921	9,376,098	8,497,773	7,271,207
Mallrat dhe Shërbimet	1,381,830	1,534,508	1,374,075	1,204,039	1,196,406
Shërbimet komunale	222,242	247,141	237,409	194,144	173,076
Subvencionet dhe Transferet	222,500	227,072	211,079	242,980	163,193
Investimet Kapitale	3,688,847	4,389,647	3,716,732	3,964,919	3,439,329

**Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - pranimit ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimit	2014 Pranimit	2013 Pranimit
Të hyrat vetjake	1,675,237	1,675,327	1,400,925	1,369,707	1,213,178

Siç shihet nga tabela të hyrat vetjake kanë shënuar një ngritje në krahasim me vitin e kaluar për 31,218€ apo rreth 2%.

### Çështja 5 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte i kënaqshëm, por brenda kategorive ekonomike ka diferenca. Realizim pak më i ulët i shpenzimeve ishte në kategorinë investime kapitale 85% dhe mallra dhe shërbime 89.5%. Kjo, për shkak se mjetet financiare për disa projekte kapitale ishin ri destinuar, dhe disa projekte tjera nuk ishin planifikuar me saktësinë e duhur, dhe si të tilla, kanë dështuar të zhvillohen procedurat e prokurimit.

**Rreziku** Planifikimi jo i duhur i disa projekteve kapitale i ka pamundësuar komunës të realizoj buxhetin dhe për pasojë ka rezultuar me normë të ultë të ekzekutimit. Mos realizimi i projekteve të tilla, siç parashihet me planifikim, ndikon në mos arritjen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një planifikim i mirëfilltë i projekteve kapitale në mënyrë që projektet të realizohen ashtu siç buxhetohen në tabelat e buxhetit.



## 3.4 Prokurimi

Në fushën e prokurimit kemi rishikuar 11 procedura të prokurimit në vlerë totale 1,790,398€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun në përfundimin e kontratave dhe ekzekutimin e tyre. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit. Ne kemi identifikuar disa dobësi në fushën e prokurimit të cilat po i prezantojmë më poshtë:

---

### Çështja 6 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Ne kemi vërejtur në pesë raste që proceduarat e prokurimit ishin zhvilluar pa hartuar projektin ekzekutiv ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2014 të lëshuar nga KRPP.

Nga të gjitha rastet e rishikuara, zotimi i mjeteve është bërë pas inicimit të procedurave të prokurimit. Kjo është në kundërshtim me LMFPP neni 36.1

Në dy raste kemi vërejtur që personi që kishte përgatitur specifikimet teknike të dosjes së tenderit (paramasën dhe parallogarinë) njëkohësisht ishte anëtar i komisionit për vlerësim të ofertave dhe menaxher i projektit. Kjo është në kundërshtim me nenin 56 pika 4 të udhëzimit Operativ të Prokurimit.

**Rreziku** Mangësitë e identifikuara gjatë proceseve të prokurimit/monitorimit rrisin rrezikun e: hyrjes në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme; që punimet të mos bëhen sipas standardeve të ndërtimit dhe mund të mos plotësoj nevojat e qytetareve; dhe ndarja e detyrave të mos jetë e duhur duke paraqitur kërcënim të vet rishikimit të punëve.

**Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për gjetjet e auditimit për rastet ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse dështimet kanë ndodhur dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme.

## Çështja 7 - Dobësitë jo sistematike - Prioritet i lartë

### E gjetura

Në projektin "Ndërtimi i shkollave fillore Druar, Pantinë dhe Maxhunaj" komuna kishte lidhur kontratë në vlerë 867,757€, edhe pse buxheti i parashikuar për këtë projekt për tri vite ishte 800,000€. Pra, komuna kishte hyrë në obligime më shumë se sa ndarjet e parashikuara buxhetore për 67,757€.

Gjithashtu, gjatë vlerësimit të ofertës së fituesit kemi vërejtur që ofertuesi nuk i kishte mbledhur në total disa nën pozicione tek shkollat Druar dhe Maxhunaj. Si rezultat i mos korigjimit të ofertës nga ana e komisionit të vlerësimit kontrata është lidhur në vlerë 867,575€ ndërsa oferta e korigjuar ishte në vlerë 870,000€, pra për 2,246€ më e lartë se kontrata. Kjo mund të sjell shpenzime me të larta për komunën se sa vlera e kontraktuar.

Përveç kësaj, komuna nuk kishte harmonizuar kontratën me ndryshimet në ligjin e TVSH-së (prej 16% në 18%). Komuna ka pranuar faturat gabimisht me ç'rast çmimet janë azhurnuar duke shtuar 2% në vlerën totale, e jo në çmimin bazë (pa TVSH). Kjo ka bërë që komuna për tri pagesa të realizuara në vitin 2015 në vlerë totale prej 170,000€ për këtë projekt ka pagur OE me tepër për 460€. Pra, sipas përlllogaritjeve të faturave, i bie që komuna ka paguar TVSH gabimisht si 18.32% apo për çdo çmim që është ofertuar para shtatorit 2015, komuna kishte paguar 0.271% më shumë secilin pozicion. Sipas kësaj përlllogaritjeje, për pagesat në total, komuna do të paguaj më tepër vlerën e TVSH prej 2,394€.

Në projektin "Asfaltimi i rrugës Wesley Clark" në vlerë 177,485€ komuna kishte lidhur kontratë 01.04.2015 me OE të pa përgjegjshëm. OE i përzgjedhur nuk kishte ofertuar për tri pozicione, ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit. Përveç kësaj punimet duhej të fillonin tri ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe të përfundonin brenda 90 ditësh kalendarike. Ne vërejtëm se punimet kishin filluar me 5 muaj vonesë. Sipas menaxherit të projektit, vonesat janë shkaktuar pasi që në të njëjtën rrugë ishte duke u implementuar projekti për ujësjellësin. Edhe pse projekti konsiderohet si i përfunduar, deri në kohën e auditimit pranimi teknik i tij ende nuk ishte bërë.

**Rreziku** Rastet e identifikuara më lartë tregojnë për kontrolle të dobëta tek procesi i prokurimit. Hyrja në kontratë përtej ndarjeve buxhetore, rritë rrezikun serioz që komuna të mos mund t'i kryej detyrimet ndaj debitorëve dhe rastet të procedohen në gjykata apo ekzekutimi i pagesave të bëhet në mënyrë direkte nga Thesari. Mos korrigjimi i çmimeve të ofertës mund të sjell shpërblimin e OE me çmime më të larta së konkurrenca. Mos harmonizimi i ndryshimeve fiskale (ndryshimet e TVSH-së) në kontratat aktuale mund të rezultojë me humbje financiare për komunën. Mos zbatimi i kriterëve të tenderit mund të rezultojë në cilësi potencialisht të dobët të punës, si dhe të mos pranohet vlera për parane e shpenzuar. Vonesat në realizimin e projekteve zvogëlojnë përfitimin e qytetarëve.

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj se komuna nuk do të hyjë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore të parashikuara me ligjin e buxhetit. Të sigurojë se do të ndërmerren veprime konkrete që kërkesat e vendosura në dosje të tenderit do të zbatohen më përpikëri dhe komisionet e vlerësimit duhet të mbikëqyren në mënyrë rigoroze nga menaxheri i prokurimit në mënyrë që të shmangen mangësitë e identifikuara. Rastet ku ka vonesa të konsiderueshme në ekzekutimin e punimeve nga operatorët ekonomik të ndërmerren masa ligjore dhe të aplikohen penalet sipas kushteve të kontratës. Të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar në mënyrë që të mos dëmtohet me tutje buxheti i komunës.

#### **Çështja 8 – Shpërblimi me kontratë OE të pa përgjegjshëm - prioritet i lartë**

**E gjetura** Kriter në dosjes të tenderit në projektin “Asfaltimi i rrugëve lokale në zona rurale” ishte: OE që nuk kanë bazë të asfaltit dhe nëse vlera e furnizimit me asfalt nuk kalon 40% të vlerës së përgjithshme të ofertës, duhet të veprojnë konform nenit 30 të LPP (të nënshkruhet marrëveshje e nën kontraktimit) në të kundërtën të veprojnë konform nenit 71 (formim i grupit të OE). Në bazë të këtij kriteri OE me çmimin më të ulët ishte eliminuar (vlera e ofertës 82,781€) sepse sipas marrëveshjes për nënkontraktim kishte tejkalluar për 40.37% pozicionin për furnizim dhe ekzekutim të asfaltit. Në dosje të tenderit pozicioni D.4 furnizimi dhe ekzekutimi i asfaltit ishin paraparë në një pozicion.

Ndërsa, komuna kishte lidhur kontratë me OE në shumë 100,310€ edhe pse OE kishte marrëveshje për furnizim me asfalt që tejkallon vlerën totale të ofertës për 59%.

Përveç kësaj, projekti nuk ishte përfunduar sipas paramasës, sepse rruga në fshatin Gojbulë ishte kontraktuar 1,400m<sup>2</sup> asfalt ndërsa ishin shtruar 1,340m<sup>2</sup>. Zyra e prokurimit nuk kishte ndonjë shpjegim lidhur me mos ekzekutimin e punimeve sipas kontratës.

**Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ndikon me shpërblim të kontratës OE të pa përgjegjshëm. Fakti që OE nuk i kishte përmbushur kriteret e kërkuara në dosje të tenderit, rritë rrezikun e pa përgjegjshmërisë në procesin e ekzekutimit të kontratës.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit të bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm me OE të përgjegjshëm.

### **Çështja 9 - Ndërtimi i objektit për mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave në fshatin Bukosh-Prioritet i lartë**

**E gjetura** Komuna gjatë vitit 2015 kishte zhvilluar tri procedura të prokurimit për ndërtimin e "Objektit për mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave në Bukosh". Sipas projektit të hartuar nga kompania kontraktuese objekti parashihet të kushtojë 111,000€, ndërsa projekti ishte ndryshuar në vlerë substanciale nën arsyetimin se buxheti i planifikuar për objekt ishte rreth 50,000€. Sipas menaxherit të projektit këto ndryshime ishin bërë në bashkëpunim me kompaninë projektuese.

"Ndërtimi i objektit për mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave në fshatin Bukosh-faza I". Komuna kishte tenderuar projektin me ndryshime dhe kishte lidhur kontratë për ndërtim në shumë 29,682€. Ne kemi testuar procesin e prokurimit dhe kemi identifikuar që fillimi i procedurave të prokurimit ishte bërë në mungesë të lejes së ndërtimit nga komuna dhe pëlqimin mjedisor dhe lejen mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Më tutje, kontrata ishte lidhur me OE të pa përgjegjshëm pasi që kriter obligativ në dosjen e tenderit ishte dëshmia mbi pagesën e plotë të tatimit në pronë (origjinal) derisa OE e kishte ofruar dokumentin e tillë në kopje.

Me datë 29.05.2015 komuna kishte shpallur procedurë (kuotim çmimi) për "Ndërtimin e objektit për mbledhjen dhe paketimin e mbeturinave të riciklueshme - faza II. Në këtë fazë parashihej që të finalizoheshin disa pozicione të cilat nuk ishin përfshirë në fazën e I-rë. Komuna kishte lidhur kontratë në vlerë 9,136€ me OE të pa përgjegjshëm pasi që kriter obligativ në dosjen e tenderin ishte dëshmia mbi pagesën e plotë të tatimit në pronë (origjinal) dhe lista e stafit origjinal derisa OE i kishte ofruar dokumente të tilla kopje.

Gjithashtu me datë 05.10.2015 komuna kishte shpallur procedurë të hapur për të njëjtin objekt faza III për t'i mbuluar edhe disa pozicione tjera në mënyrë që të përmbushet vlera e parashikuar e projektit. Komuna kishte shpërblyer me kontratë OE të papërgjegjshëm pasi që kriter obligativ në dosjen e tenderit ishte dëshmia mbi pagesën e plotë të tatimit në pronë (original) dhe lista e stafit original derisa OE e kishte ofruar dokumente të tilla kopje.

Nga gjetjet më lart shihet se zyra e prokurimit kishte bërë ndarje të tenderëve pasi që për të njëjtin projekt kishte bërë tri procedura të prokurimit duke shpërblyer operatorë të ndryshëm. Si rezultat i kësaj, gjatë ekzekutimit të punimeve, kishte mos koordinim dhe mosmarrëveshje lidhur me përfundimin e disa pozicioneve në mes të OE.

#### **Rreziku**

Ndryshimi i projektit dhe ndarja e procedurave të tenderimit për të njëjtin projekt, paraqet rrezik që objekti i tillë të mos arrijë objektivat e caktuara. Gjithashtu, kjo ka shtuar mundësinë e dëmtimit të cilësisë së objektit për faktin se kishte ndryshime të mëdha tek shumë pozicione të parapara me projekt. Shpërblimi me kontrata operatorët e pa përgjegjshëm, rritë rrezikun që ekzekutimit i projektit të mos jetë i kualitetit të pritur. Shmangia e kërkesave ligjore lidhur me pajisjen me dokumentet relevante nga institucionet përkatëse mund të sjell mos funksionalizimin e këtij projektit.

#### **Rekomandimi 9**

Kryetari duhet të inicioj shqyrtimin e rastit dhe të siguroj se paramasat, paralogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen janë kryer në mënyrë të hollësishme dhe se devijimet nga projektet e hartuara do të jenë minimale. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësisë dhe të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP dhe ligjeve tjera relevante. Gjithashtu, të siguroj se në të ardhmen nuk do të përsëriten praktikat e ngjashme.

## 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### 3.5.1 Pagesat tjera

Komuna kishte bërë shpenzime në bazë të disa marrëveshjeve të mirëkuptimit apo të bashkëpunimit.

---

#### Çështja 10 – Marrëveshje bashkëpunimi – Prioritet i lartë

**E gjetura** Me 01.12.2014 Kuvendi Komunal ka shqyrtuar dhe miratuar projektin për investime në infrastrukturë të ujësjellësit në Vushtrri KSV 015 për vitin 2015-2016 me financim të përbashkët të Lux Development (Lux Dev) dhe të komunës. Kryetari me 04.12.2014 kishte lidhur marrëveshje të mirëkuptimit me Lux Dev për projektin përkrahja institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në regionin e Mitrovicës faza II (Projekti KSV 018). Këtij memorandumit i ka paraprirë një marrëveshje në mes Qeverisë së Luksemburgut dhe Qeverisë së Kosovës, e nënshkruar nga Ministrat përgjegjës me datën 25.07.2014. Llogaritja e koston për financimin e këtij projekti vlerësohet të jetë 760,000€. Sipas marrëveshjes, Qeveria e Luksemburgut do të financojë 460,000€, ndërsa komuna 300,000€, të cilat duhet t'i depozitojë në llogarinë e përfaqësuesit të Lux Developmentit e që është "Kosovo Petroleum Company". Komuna kishte paguar 30,000€ me 11.08.2015. Për vlerën 30,000€, komuna nuk ka përfituar kundërvlerën për mjetet e dhëna për shkak se punimet priten të fillojnë në vitin 2016.

Komuna me 25.03.2015 kishte lidhur marrëveshje me CHWB për bashkëfinancim të projektit "Plani i Konservimit në Vushtrri që përfshinë trekëndëshin: Ura e Gurit, Hamami dhe Kalaja". Sipas marrëveshjes parashihet që CHWB të kontribuoj 4,625€ ndërsa komuna 20,905€. Me këtë marrëveshje palët pajtohen që CHWB të jetë zbatuese e projektit dhe mjetet financiare të barten në dy këste: 10,000€ kësti parë, 30 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe kësti i dytë 10,905€, tre muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes. Ne identifikua që komuna kishte paguar nga investimet kapitale në llogari të CHWB-së shumën 10,000€ para se të fillohen punimet në realizim të projektit. Për më shumë, komuna ka një raport narrativ mbi ecurinë e punimeve, por nuk ka dëshmi (fatura) se sa është shuma e investuar për realizimin e projektit. Marrëveshja e më sipërme nuk është në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) neni 4 pika 2 sepse nëse projekti financohet mbi 50% nga entiteti, atëherë komuna duhet të jetë autoritet kontraktues.

Kryetari me 31.07.2015 kishte lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Organizatën për Zhvillim Rural "OZHR Mëshqerra" për realizimin e projektit të përbashkët nga lëmi i blegtorisë. Sipas marrëveshjes projekti do të jetë tre vjeçar dhe do të përfshijë një ndihmë prej 200 krerë të dhive qumështore për 20 familje. Vlera totale e projektit do të jetë 89,070€. Komuna do të participoj vlerën 38,000€ (30,000€ për blerje të dhive dhe 8,000€ për blerjen e dy laktofrizëve), përfituesit participojnë vlerën 9,000€ ndërsa OZHR Mëshqerra vlerën 42,070€ për blerje të imputeve bujqësore, shpenzime të makinës, trajnime, staf profesional dhe shpenzime të zyrës. Sipas marrëveshjes, komuna do të paguaj në llogari të OZHR Mëshqerra vlerën 39,000€ (përfshirë participimin e qytetarëve) deri në gusht 2015. Komuna duke u bazuar vetëm në marrëveshje dhe pa raport të pranimit kishte paguar shumën prej 30,000€ prej të cilave 4,000€ më 19.10.2015 dhe 26,000€ më 16.11.2015. Ndërsa sipas raportit të pranimit, dhitë qumështore janë pranuar me datë 23.11.2015. Po ashtu, komuna nuk ka ndonjë dëshmi bindëse për të siguruar nëse mjetet e zotuar nga donatori (pjesëmarrja e donatorit) sipas marrëveshjes ishin shpenzuar për këtë projekt.

## **Rreziku**

Ekzekutimi i pagesave nga komuna para konfirmimit që shërbimet janë përfunduar nga ana e donatorëve shoqërohen me rrezikun potencial që objektivat e marrëveshjeve të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen. Derisa komuna nuk ushtron mbikëqyrje aktive në realizimin e projekteve dhe nuk posedon asnjë garanci se donatorët do të përfundojnë projektet sipas marrëveshjeve, këto pagesa mund të konsiderohen të parregullta dhe mund t'i shkaktojnë komunës dëme të konsiderueshme financiare.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëjë pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me fatura dhe raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjerohim që praktikat e tilla të pagesave të ndërpriten.

#### **Çështja 11 - Kontrata për shërbime të veçanta- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Komuna gjatë vitit 2015 kishte angazhuar 16 punonjës me kontrata për shërbime të veçanta. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime në shumë 22,067€. Të gjitha kontratat ishin lidhur për pozita të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse.

**Rreziku** Lidhja e kontratave për shërbime të veçanta për pozita të zakonshme ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe kjo tregon që shërbimet të mos jenë reale me nevojat e komunës.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta si dhe të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme.



### 3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 9,402,921€, ndërsa shpenzimet 9,376,098€ apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel lokal kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori. Ne kemi testuar testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me kontratat, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, dhe punëtorët të cilët ishin pensionuar.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 ishte 227,072€ ndërsa ishin shpenzuar 211,079€. Ne kemi vlerësuar procesin e dhënies së subvencioneve dhe identifikuam mangësitë si më poshtë.

---

#### Çështja 12 - Procedimi i subvencioneve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Komuna, sipas vendimit të Kuvendit Komunal të datës 29.09.2014 kishte ndarë 10,000€ për ta subvencionuar një qytetar të Vushtrrisë. Sipas vendimit nuk dihet qëllimi i ndarjes së këtij subvencioni. Pagesa prej 10,000€ ishte bërë me 03.07.2015 në llogarinë e përfituesit. Më tutje, Kuvendi i Komunës nuk kishte respektuar rregulloren në procesin e dhënies së subvencioneve pasi që përfituesi i këtij subvencioni nuk ishte proceduar përmes drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Përveç kësaj identifikuam tri raste ku përfituesit e subvencioneve nuk kishin raportuar në kohën e duhur lidhur me përfundimin e projekteve.

**Rreziku** Mos raportimi lidhur me mënyrën e shpenzimit të mjeteve të dhëna, rritë rrezikun se fondet e tilla të mos arrijnë qëllimin e caktuar.

**Rekomandimi 12** Komuna duhet siguroj se do respektohen kriteret e vendosura në rregulloren e brendshme komunale dhe të siguroj që përfituesit e subvencioneve të raportojnë lidhur me shfrytëzimin e fondeve në mënyrë që subvencionet të arrijnë objektivat për të cilat janë dhënë.

## 3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin në vlerë 1,400,925€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, nga shfrytëzimi i pronës publike dhe të hyrat nga niveli qendror etj.

---

### Çështja 13 - Të hyrat vetjake- Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2015 kishte planifikuar 446,000€ ndërsa kishte mbledhur 427,209€. Sipas të dhënave nga sektori i tatimit në pronë, komuna ka në evidencë 21,187 prona të regjistruara.

Komuna në vitin 2015 kishte bërë 963 verifikime të pronave ekzistuese që do të thotë se nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 të pronave në komunën e Vushtrrisë, ashtu siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronë të pa luajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Sektori i tatimit në pronë nuk kishte mbajtur një evidencë për objektet komerciale të cilët nuk zhvillojnë afarizëm. Sipas nenit 17 të UA 03/2011 objektet e tilla duhet të tatimohen me 70% të vlerës së tregut të objekteve komerciale dhe zyra komunale duhet të identifikoj dhe të mbajë një evidencë për objektet e tilla.

Përveç kësaj, ne identifikuam që bashkësia islame nuk kishte kryer obligimet tatimore ndaj komunës lidhur me tatimin në pronë edhe pse në kuadër të objektit të Xhamisë zhvillojnë afarizmin e tyre disa lokale. Për një rast, vlera e obligimit të pa shlyer ishte 27,728€.

**Rreziku** Tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave të komunës, dhe dështimi në mbledhjen e këtij tatimi, ka ndikim direkt në realizimin e projekteve kapitale dhe financimet tjera me burime vetjake . Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë dhe të mbajë një evidencë për objektet komerciale te cilat nuk zhvillojnë afarizëm.

#### Çështja 14 - Lejet e ndërtimit- Prioritet i lartë

- E gjetura** Në procesin e auditimit kemi rishikuar pesë mostra lidhur me përlllogaritjen e taksës komunale për leje të ndërtimit dhe identifikuar se përlllogaritja e tarifës për hapësirë të banimit nuk ishte konsistente. Nga pesë mostra të testuar identifikuar se në dy raste sipërfaqja e bodrumit ishte trajtuar si hapësirë e banimit dhe ishte ngarkuar me taksë dhe tarifë komunale për leje të ndërtimit, ndërsa në tre raste tjera nuk ishin zbatuar kriteret e njëjta.
- Rreziku** Përlllogaritja jo konsistente e taksës për leje të ndërtimit ndikon në trajtim jo të barabartë të qytetarëve.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se me rastin e ngarkesës me taksë për leje të ndërtimit qytetarët do të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke mos i dëmtuar padrejtësisht qytetarët.

#### Çështja 15 - Menaxhimi i pronës komunale - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna në vitin 2015 kishte organizuar ankand publike për dhënien e tokës bujqësore në shfrytëzim afatshkurtër për 57 hektarë e 69 ari. Megjithatë, sipas regjistrit të ofruar nga drejtoria e kadastrit komunal, janë edhe 419 hektarë tokë bujqësore që aktualisht nuk shfrytëzohen. Kjo sipërfaqe potenciale, po ashtu, mund të ishte subjekt trajtimi i dhënies me qira nga ana e komunës, dhe do të sillte përfitime edhe për komunën, edhe për shfrytëzuesit.
- Rreziku** Mos shfrytëzimi në mënyrë efektive dhe ekonomike i resurseve komunale, rezulton me nivele të ulta të krijimit të të hyrave, dhe rrjedhimisht redukton aftësinë financuese të komunës për realizimin e projekteve shtesë të infrastrukturës.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të siguroj se do të bëhet një analizë më gjithëpërfshirëse e sipërfaqeve potenciale të tokave për t'u dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, me qëllim të maksimizimit të përfitimit edhe të komunës dhe të qytetarëve.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna gjatë vitit 2015 kishte trajtuar rekomandimin e vitit paraprak për regjistrimin e pasurisë, por nuk kishte arritur të adresoj plotësisht rekomandimin për pasuritë. Si rezultat i vazhdimit të të procesit të regjistrimeve, komuna në PVF ishte raportuar vlera e pasurisë 110,877,955€, që krahasuar me vitin paraprak (46,157,808€) ka një rritje prej 64,720,147€.

Ne vlerësojmë përkushtimin nga menaxhmenti për të regjistruar dhe mirëmbajtur regjistrin e pasurisë. Përkundër kësaj, gjate rishikimit të regjistrin të pasurive, ne kemi vërejtur:

---

#### **Çështja 16 - Regjistri i pasurisë jo i plotë- Prioritet i lartë**

**E gjetura** Gjatë vitit 2015 identifikua që komuna nuk kishte regjistruar në regjistrin kontabël 3 pagesa në vlerë totale prej 80,000€ (60,000€ për renovim të objekteve dhe 20,000€ për objekte memoriale).

Lidhur me investimet në vijim, identifikua se tri projekte edhe pse kishin përfunduar, komuna nuk kishte azhurnuar regjistrin e pasurisë për t'i trajtuar si projekte të përfunduara.

Sipas raportit të pranimit teknik vlera e objektit për riciklim të mbeturinave ishte 29,207€ (pranimi teknik 27.10.2015), ndërsa në regjistrin e pasurisë komuna e kishte regjistruar pagesën në vlerë 11,819€ si projekt të përfunduar; pagesën në vlerë 3,314€ si investime në vijim ndërsa pagesën në vlerë 14,072€ komuna nuk e kishte regjistruar fare në regjistër të pasurive.

Komuna kishte paguar shumën 30,000€ në llogari të Lux Development për projektin e ujësjellësit (projekt me bashkëfinancim) dhe të njëjtën pagesë e kishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë. Ne kemi vërejtur që këto mjete akoma nuk ishin investuar nga Lux Dev.

Komuna në PVF e vitit 2015 kishte shpalosur vlerën prej 79,150€ për pasuritë nën 1,000€. Ndërsa në programin e E-pasurisë vetëm për administratë komunale figuron vlera prej 197,922€. Pra, kemi një shpalosje të pa saktë për 118,772€. Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna në PVF ka prezantuar vetëm pasuritë e përfituara në vitin 2015. Më tutje, në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ nuk ishin pasuritë nga drejtorati i arsimit dhe drejtorati i shëndetësisë.

**Rreziku** Mos regjistrimi i plotë dhe saktë i të gjitha pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rritë rrezikun që ato të keqpërdoren dhe me ndikim në mbivlerësim/nënvlerësim të pasurisë së komunës. Regjistrimi i mangët dhe jo i plotë i pasurive, bënë që regjistri të jetë jo i besueshëm. Kontrollat jo efektive në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar në keq deklarim të pasurive.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen të gjitha procedurat e regjistrimit të pasurive komunale në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurive.

### 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogaritë e arkëtueshme (Ll / A ) në komunë në fund të vitit 2015 ishin 2,837,490€, me një rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak (2,798.600€). Struktura e këtyre llogarive përbëhet: nga tatimi në pronë në shumë 2,256,870€, taksa në biznes 551,930€, nga qiradhënia 26,110€ dhe nga çerdhja Foleja 2,580€.

---

#### Çështja 17 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme -Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ne rishikuam llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë dhe identifikuam që ato ishin zvogëluar për 80,020€. Ky zvogëlim kishte ndodhur për shkak të vendimit të faljes së borxheve në tatimin në pronë. Në PVF komuna i kishte prezantuar Ll / A për taksa në biznes në vlerë 551,930€, që krahasuar me vitin e kaluar (433,190€), kishte një rritje për 118,740€. Gjatë vitit 2015 komuna nuk kishte ndërmarr ndonjë veprim për të zvogëluar llogaritë e arkëtueshme për taksat e biznesit.
- Rreziku** Mos arkëtimi i borxheve mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo efikase të komunës në trajtimin e këtyre llogarive, kanë rezultuar në rritjen e tyre dhe kjo rritje rrezikon e mos realizimit të projekteve komunale të planifikuara nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurojë inicimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim.

### 3.7.3 Trajtimi i borxheve

Komuna ka filluar zbatimin e rekomandimit për protokollim e faturave. Ajo gjatë vitit 2015 kishte raportuar obligimet në Thesar në baza të rregullta mujore. Shuma e obligimeve të cilat i ka raportuar në PVF 2015 është 61,750€, nivel gati i njëjtë me vitin 2014 (65,260€).

#### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim në Pasqyrat Financiare (çështja 1)	Kryetari duhet të identifikoj arsyet për gabimet e bëra në PVF dhe të siguroj se proceset e rishikimeve nga menaxhmenti do të përmirësohen për PVF e vitit 2015 në mënyrë që të sigurohet se gabimet janë identifikuar dhe korrigjuar para se PVF të dorëzohen në Qeveri.		X	
3. Rekomandimet e vitit paraprake. (Çështja 2)	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar përcakton një orar të qartë të zbatimit, personat përgjegjës dhe aktivitetet të nevojshme për adresimin e rekomandimeve. Planin duhet të përmbaj prioritete dhe të përqendrohet fillimisht në trajtimin e fushave të rëndësishme më të madhe, si dhe të mbikëqyret direkt nga Kryetari i Komunës		X	
4.2 Të hyrat (Çështja 3)	Kryetari duhet të siguroj që kushtet e kontratës të arritura me shfrytëzuesit e pronave publike të zbatohen në mënyrë strikte dhe që shfrytëzuesit e pronave komunale të kryejnë obligimet financiare me kohë. Në të kundërtën, kontratat duhet të rishikohen apo të shfuqizohen.	x		
4.3.1 Prokurimi (Çështja 4)	Kryetari duhet të inicioj një analizë për arsyet pse kanë ndodhur dhe të siguroj që zhvillim i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontrata vetëm OE të përgjegjshëm.			x

Dobësitë jo sistematike (Çështja 5)	Kryetari duhet të inicoj shqyrtimin e rastit pse menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës nuk kanë zbatuar punimet sipas kontratës fillestare si dhe të siguroj se paramasat , parallogarite dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen kryhen në mënyrë të hollësishme dhe devijimet nga kontratat fillestare të jenë minimale. Pas shqyrtimit të rastit ndaj personave përgjegjës të inicoj masa adekuate të përgjegjësisë. Gjithashtu, Kryetari duhet te siguroj se në të ardhmen nuk do të përsëritën praktikatat e ngjashme.	x		
4.3.2 Shpenzimet tjera (Çështja 6)	Kryetari duhet te siguroj se arsyeshmëria e pagesave në avancë për bashke financime të analizohet detajisht. Me tutje , Marrëveshja duhet te përmbaj kërkesën për raportimin e rezultateve gjate implementimit e cila siguron një baze solide për monitorim. Raportet finale duhet te sigurohen dhe te behën publike për te siguruar transparencën.			x
4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale. (Çështja 7)	Kryetari duhet të siguroj se te gjitha procedurat e regjistrimit te pasurive do te zbatohen sipas planit kontabël dhe ne pajtim me kërkesat tjera te rregullores për menaxhimin e pasurive qeveritare.		X	
4.4.2 Llogaritë e arkëtueshme- (çështja 8)	Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, dhe duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.			x
4.4.3Trajtimi i Borxheve- (çështja 9)	Kryetari duhet të siguroj që të gjitha faturat të pranohen dhe si te tilla të protokolohen dhe të evidentohen në librin e faturave si dhe bëjnë likuidimin e tyre me kohë.		x	
5. Sistemi i Auditimit të Brendshëm. (çështja 10)	Kryetari duhet të siguroj që NJAB në planin vjetor të auditimit te përfshijë auditimin e llojeve të ndryshme të shpenzimeve dhe të hyrave, me fokus te veçantë kategoritë që shoqërohen nga nivele të larta të rrezikut.	x		